

UDHËZIM

MBI PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË RIMBURSIMIT TË TVSH-SË SË EKSPORTUESVE BAZUAR NË ANALIZËN E RISKUT

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, si dhe pikës 16.1 të udhëzimit nr.7, datë 19.1.2005 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, Ministri i Financave

UDHËZON:

Kategorizimi i eksportuesve në tre grupe (A, B dhe C) në procesin e rimbursimit të TVSH-së mbështetet në funksion të analizës së riskut që paraqet rimbursimi i tyre për të ardhurat tatimore.

Në grupin A do të përfshihen eksportuesit me risk minimal, që do të kenë përparësi në periudhën kohore për rimbursimin e TVSH-së. Në këtë grup do të klasifikohen ato shoqëri eksportuese që:

1. prodhojnë 100 % për eksport;
2. kanë një aktivitet eksportues mbi 3 vjet;
3. nuk kanë asnjë vlerësim tatimor nga ku të kenë rezultuar detyrime tatimore, sipas metodave alternative të përcaktuara në nenin 36 të ligjit “Për procedurat tatimore”, që mund të jenë bërë nga vlerësuesit apo kontrollorët e administratës tatimore;
4. përdorin dokumentim dhe mbajtje të llogarive kontabile konform kërkesave të ligjit “Për kontabilitetin” dhe ligjit “Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimet”;
5. pagesa të sakta dhe në kohë të detyrimeve tatimore, doganore dhe atyre të sigurimeve shoqërore;
6. është ushtruar kontroll i thelluar nga organet tatimore, të paktën një herë në 2 (dy) vitet e fundit;
7. paraqitje e listës së nënkontraktorëve me të cilët ata punojnë.

Në grupin B do të përfshihen eksportuesit me risk mesatar që do të renditen pas grupit A në periudhën kohore për rimbursimin e TVSH-së. Në këtë grup do të klasifikohen ato shoqëri eksportuese që:

1. eksportojnë më shumë se 50 % të prodhimit të tyre;
2. kanë një aktivitet jo më pak se 3 vjet;
3. nuk kanë vlerësime tatimore nga ku kanë rezultuar detyrime tatimore, sipas metodave alternative të përcaktuara në nenin 36 të ligjit “Për procedurat tatimore”, që mund të jenë bërë nga vlerësuesit apo kontrollorët e administratës tatimore;
4. përdorin dokumentim dhe mbajtje të llogarive kontabile konform kërkesave të ligjit “Për kontabilitetin” dhe ligjit “Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimet”;
5. pagesa të sakta dhe në kohë të detyrimeve tatimore, doganore dhe atyre të sigurimeve shoqërore;

6. është ushtruar kontroll i thelluar nga organet tatimore, të paktën një herë në 3 vitet e fundit;
7. paraqitje e listës së nënkontraktorëve me të cilët ata punojnë;

Në grupin C do të përfshihen eksportuesit me risk të lartë ku do të grupohen të gjitha shoqëritë e tjera eksportuese, që kanë mbetur sipas kriterëve për këtë kategori. Gjithsesi, ato do të planifikohen për kontroll, përpara bërjes së një rimbursimi.

Për secilin grup, secili kriter sipas rëndësisë që ka do të ketë pikë të caktuara, ku të gjitha kriteret bashkë do të plotësojnë masën e 75 pikëve. Pragu për të kategorizuar në secilin grup do të jetë 60 pikë.

Mosplotësimi i pikavarazhit sipas pikëve të secilit grup, e kalon automatikisht tatimpaguesin në një kategori më të ulët.

Gjithashtu do të planifikohen për kontroll të gjitha ato shoqëri që, megjithëse janë klasifikuar si me risk të ulët ose mesatar, në raste të veçanta, paraqesin kërkesa për rimbursim me shuma të mëdha, larg kërkesës normale të tyre.

Përsa u përket procedurave të kategorizimit, shoqëria eksportuese bën vetë kategorizimin, i cili vlerësohet nga administrata tatimore. Mbi bazën e rezultatit, administrata tatimore i lëshon një certifikatë kategorie (A, B ose C).

Certifikimi për kategorizim bëhet pa afat. Kalimi nga kategoria më e ulët në atë më të lartë bëhet me aplikimin e tatimpaguesit eksportues, ndërsa kalimi nga kategoria më e lartë në atë më të ulët bëhet nga administrata tatimore mbi bazën e rezultateve të kontrollit tatimor.

Procedurat e rimbursimit të TVSH-së janë ato që përshkruhen në udhëzimin e Ministrit të Financave nr.7, datë 19.1.2005 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”. Mbi bazën e analizës së riskut, eksportuesit e kategorisë A do të rimbursohen 15 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim, ata të kategorisë B – 25 ditë dhe eksportuesit e kategorisë C për 30 ditë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCEVE
Arben Malaj

KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E RISKUT

Kriteret për risk minimal A	Pike te mundeshme	Pike nga aplikuesi	Pike nga administrata tatimore	Kriteret për risk mesatar B	Pike nga aplikuesi	Pike nga administrata tatimore	Kriteret për risk të lartë C	Pike nga aplikuesi	Pike nga administrata tatimore
1. prodhojnë 100% për eksport	25			1. eksportojnë më shumë se 50% të prodhimit të tyre			1. eksportojnë më shumë se 50% të prodhimit të tyre		
2. kanë aktivitet eksporti më shumë se 3 vite	10			2. kanë aktivitet eksportues jo më pak se 3 vite			2. kanë aktivitet eksportues deri në 1 vit		
3. nuk kanë asnjë vlerësim tatimor nga ku të kenë rezultuar detyrime tatimore, sipas metodave alternative të përcaktuara në Nenin 36 të ligjit “Për procedurat tatimore”, që mund të jenë bërë nga vlerësuesit apo kontrollorët e administratës tatimore;	10			3. nuk kanë asnjë vlerësim tatimor nga ku të kenë rezultuar detyrime tatimore, sipas metodave alternative të përcaktuara në Nenin 36 të ligjit “Për procedurat tatimore”, që mund të jenë bërë nga vlerësuesit apo kontrollorët e administratës tatimore;			3. kanë asnjë vlerësim tatimor nga ku të kenë rezultuar detyrime tatimore, sipas metodave alternative të përcaktuara në nenin 36 të ligjit “Për procedurat tatimore”, që mund të jenë bërë nga vlerësuesit apo kontrollorët e administratës tatimore;		
4. përdorin dokumentim dhe mbajtje të llogarive kontabile konform kërkesave të ligjit “Per Kontabilitetin” dhe ligjit “Per dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive”;	10			4. përdorin dokumentim dhe mbajtje të llogarive kontabile konform kërkesave të ligjit “Per Kontabilitetin” dhe ligjit “Per dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive”;			4. nuk përdorin dokumentim dhe mbajtje të llogarive kontabile konform kërkesave të ligjit “Per Kontabilitetin” dhe ligjit “Per dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive”;		
5. pagesa të sakta dhe në kohë të detyrimeve ndaj administratës fiskale	10			5. pagesa të sakta dhe në kohë të detyrimeve ndaj administratës fiskale			5. pagesa të pasakta dhe jo në kohë të detyrimeve ndaj administratës fiskale		
6. ka kaluar kontroll nga administrata tatimore, të paktën 1 herë në 2 vitet e fundit	5			6. ka kaluar kontroll nga administrata tatimore, të paktën 1 herë në 3 vitet e			6. ka kaluar kontroll nga administrata tatimore, deri 1 vit më parë .		

				fundit					
7. paraqitje e listës së nënkontraktorëve që punojnë për llogari të eksportuesit kryesor.	5			7. paraqitje e listës së nënkontraktorëve që punojnë për llogari të eksportuesit kryesor.			7. paraqitje e listës së nënkontraktorëve që punojnë për llogari të eksportuesit kryesor.		
Total pikësh A	75			Total pikësh B			Total pikësh C		

Shenoni vlerësimin e rriskut të mundshëm sipas rezultateve të mësipërme :
(plotësohet nga administrata tatimore)

Emri i Aplikuesit :

Data :

Emri i nëpunësit tatimor:

		Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve FORMULARI I DEKLARIMIT PËR PËRCAKTIMIN E RRISKUT PËR EKSPORTUESIT	
Shënime: Plotësoni të gjitha kutitë. Shkruani “J/A“ (Jo e Aplikueshme) në ato kuti që nuk keni për të deklaruar			
PJESA I		Informacion Personal	
1. Tatimpaguesi (emri i Personit të tatueshëm)		2. NIPT	3. Emri, adresa dhe numri i telefonit të administratorit

4. Aktiviteti kryesor		5. Adresa të tjera		6. Të tjera	
7. Dega tatimeve ku aplikohet	8. Qendër	9. Filial	10.Vlera e kërkesës për rimbursim të periudhës më të fundit tatimore (në lek)	11.Numri i punonjësve	12.Fondi mujor i pagave bruto

Shënim: Kjo pjesë e formularit plotësohet nga tatimpaguesi.